



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të LogPay Financial Services GmbH nga Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 236 Prot., protokoll i AK, datë 28.03.2019, “Njoftim bashkimi”, nga Studio Ligjore Loloçi & Associates, në cilësinë e përfaqësuesi të autorizuar të palës njoftuese, me anë të së cilës informohemi në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të LogPay Financial Services GmbH nga Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Blerësi: Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft (Volkswagen Financial Services AG), shoqëri aksionare, me seli në Gifhomer Str.57, 38112 Braunschweig, regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Braunschweig me numër HRB 3790.

Volkswagen Financial Services AG është pjesë e Grupit Volkswagen, i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG).

Volkswagen AG shoqëri aksionare, me seli në Berlin Ring 2, 38440 Wolfsburg, regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Braunschweig-ut me numër HRB 100484.

Grupi Volkswagen ka tre entitete të themeluara në Shqipëri: Porsche Leasing SHPK, Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK.

Porsche Albania SHPK, regjistruar më 05.07.2005 me objekt të aktivitetit shitje me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerjen e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve etj. Ortak me 100% të kuotave është Porsche Holding Gesellschaft m.b.H.

Porsche Leasing SHPK, regjistruar më 23.04.2013 me objekte të aktivitetit veprimtari të qirasë financiare, agjent në sigurime. Ortakë i kësaj shoqërie është Porsche Bank Aktiengesellschaft me 100% të kuotave.

Porsche Mobility SHPK, regjistruar më 23.04.2013 me objekt të aktivitetit çdo formë e aktivitetit, veprimtarisë së qirasë operationale siç parashikohet nga dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Ortakë me 100% të kuotave është Porsche Bank Aktiengesellschaft.

Shitësi: DVB Bank SE me adresë biznesi në Platz der Republik 6, 60325 Frankfurt am Main, regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Frankfurtit am Main, me numër HRB 83980¹.

Targeti: LogPay Financial Services GmbH² është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me adresë biznesi në Schwalbacher Str. 72, 65760 Eschborn dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Frankfurtit am Main, me numër HRB 55461.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.

¹ Burimi: Marrëveshja e blerjes së aksioneve dhe transferimit datë 26 Shkurt 2019.

² Burimi: Ekstrakti i shoqërisë. Kapitali 2.000.000,00 Euro